



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2023:149066  
Datë: 17.12.2024  
Numri i dokumentit: 06611991

C.nr.1181/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Mirvet Thaqi, me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Palushi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M. H. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, të cilën me autorizim e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 1,009.80 euro, jashtë seancës, më 17 dhjetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit M. H. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit të lartcekur, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,009.80 euro, dhe atë:

- në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 e deri me datën 31.10.2022, shumën prej 594,00 euro,
- në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 01.07.2021 e deri me datën 31.10.2022 shumën prej 415,80 euro.

Të gjitha shumat e lartcekura, detyrohet e paditura që t'i paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të fillojë të llogaritet nga data 21.06.2023 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t'ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

### A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë me datë 21.06.2023, përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën dhe atë e sistemuar në Shkollën “Hajdar Dushi” në Gjakovë, i njëjti banon në fshatin . . . dhe udhëton nga aty, për në vend të punës në Gjakovë, duke paguar çmimin përkatës të biletës së udhëtimit. Paditësit nuk i është kompensuar nga e paditura obligimi për ushqimin në punë dhe as shpenzimet e transportit. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që për periudhën kohore prej datës 01.07.2021 e deri me datën 31.10.2022 në emër të shpenzimeve të ushqimit t'i paguhet shuma prej 594,00 euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit t'i kompensohet shuma prej 415,80 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 1,009.80 euro. Si dhe e ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 29.03.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se sipas kontratës së punës askund nuk është cekur se paditësit i takon kompensimi i shpenzimeve të ushqimit në punë, të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësi dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Ky kompensim nuk i takon as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takojnë kompensimet e tilla, prandaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësi nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, ndërsa vërtetimet nuk qartësojnë çështjen e konkretizimit sa i përket ditëve të punës, duke theksuar se dita e plotë e punës është 8 orë pune dhe nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 - 5 orëve punë aktive në shkollë. Po ashtu, sa i përket shujtave, duhet të ketë domosdoshmërisht dëshmi nga institucioni përkatës se nuk është e rregulluar forma e ushqimit

brenda institucionit dhe që nuk paguhet ndonjë shtesë për shujtë nga punëdhënësi. Gjykata ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë kërkesëpadinë edhe sa i përket kompensimit të udhëtimit pasi që nuk kanë ofruar prova materiale se kanë shfrytëzuar trafikun urban. Po ashtu, e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Tutje ka theksuar se meqenëse Kontrata kolektive nga viti 2014 e tutje ka qenë në kundërshtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe si të tilla nuk prodhojnë asnjë efekt juridike gjë që vërtetohet me shkëputjen e njëanshme të kësaj kontrate nga MASHT-i me datë 21.11.2022, andaj e paditura e ka kundërshtuar padinë edhe në këtë drejtim për shkak të mungesës së bazës ligjore. Nga të lartcekurat, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e Punës për paditësin M. H. i lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësi i lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura si Mësimdhënës në Shkollën “Hajdar Dushi” në Gjakovë, dhe i njëjti ka punuar gjithsej 297 ditë pune ( 01.07.2021 e deri me datën 31.10.2022), fakt i vërtetuar nga Vërtetimi për ditët e pranisë i lëshuar nga drejtori i kësaj shkolle, i datës 07.06.2023. Paditësi banon në fshatin . . . , fakt i vërtetuar nga certifikata e vendbanimit me numër serik B10582150, e lëshuar me datën 28.10.2024. I njëjti në ditët e lartcekura të punës ka udhëtuar nga fshati Cërmjan për në vendin e punës duke paguar biletën e udhëtimit në vlerë prej 1.00 euro, një drejtim, për relacionin . . . për në vendin e punës në Gjakovë, dhe këtë gjykata e ka vërtetuar nga kuponi fiskal i lëshuar nga shoqata e transportit SHTU, ku shihet se për relacionin në fjalë bileta kushton 1.00 euro një drejtim. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e vitit 2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditësit nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKAK, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim për ta bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, duke ia njohur shumën prej 594.00 euro, të kërkuar si në petitum të padisë. Ndërsa, sa i përket kërkesës së dytë, lidhur me shpenzimet e udhëtimit, gjykata aplikoi nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit të vitit 2021, ku në mënyrë identike, është përcaktuar se *“punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, ashtu që pasi vërtetojë çmimet e biletave si më sipër, për 297 ditë të pranisë në punë, paditësit në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit ia njohu shumën prej 415.80 euro, përkatësisht për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit, gjykata ia njohu shumën e përgjithshme prej 1,009.80 euro, të kërkuara si në kërkesëpadi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiës me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiës rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka

përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa, sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësen.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimin e të paditurës se nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 – 5 orëve punë aktive në shkollë, mirëpo gjykata ditët e pranisë në punë i ka vërtetuar përmes vërtetimit të lëshuara nga shkolla përkatëse ku punon paditësi dhe të njëjtave iu fali besimin pasi që janë të hartuara në formën e caktuar nga organi përkatës brenda kufijve të kompetencës së tij.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësi ka kërkuar që t’i kompensohen shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit për periudhën kohore prej datës 01.07.2021, e deri me datën 31.10.2022, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 21.06.2023, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit ligjor të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzojë pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për të iu kompensuar kompensimi në emër të ushqimit dhe udhëtimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarës. Rrjedhimisht paditësi, si i punësuar në arsim, nuk ka qenë i detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej ta përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e tyre në përputhje me kontratën kolektive të lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është

përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u mor sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1181/23, më 17 dhjetor 2024

Gj y q t a r i

Mirvet Thaqi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2023:149066  
Datë: 17.12.2024  
Numri i dokumentit: 06611991